

## PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – sherbim

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS: MBIQYRJE PUNIME “SISTEMIM DHE ASFALTIM I BLOKUT “12 SHTATORI”, B. RROGOZHINE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 71521000-6

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1.124.719 (nje milion e njeqind e njezet e kater mije e shtateqind e nentembedhjete) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*Argumentime:* Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në ligjin nr. 162 / 2020 “ Per Prokurimin Publik” neni 83, pika 1 si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “ Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” , Kreu V, seksioni II, neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin e Vetëdeklarimit bazohet në ligjin nr. 162 / 2020 “ Per Prokurimin Publik” neni 82, pika 1 si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “ Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” , Kreu V, seksioni II, neni 26.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas Shtojcës 9 të DST (kriteret e përgjithshme të kualifikimit).

*Argumentime:* Kërkesa bazohet në ligjin nr. 162 / 2020 “ Per Prokurimin Publik” neni 77, pika 1/a dhe 2.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. *(Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomikë arrinë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor).*

*Argumentime:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, neni 55 pika 4.

*Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues zoteron te gjitha kapacitetet financiare dhe ekonomike per te permbushur kontraten.*

**2.2.2** Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023,2024,2025) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa c të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilance te njepasnjeshme, nuk duhet të ketë raport negativ, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Argumentime:* Ky kriter bazohet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor e konsideron te rëndesishem kete kriter ne lidhje me realizimin e kontrates objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve te kerkuara ne kete kriter eshte bazuar ne Ligjin nr. 10091 , datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar”, i ndryshuar.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

*Argumentime:* Kërkesa e mësipërme është bazuar në bazë të pikës 3, të nenit 76, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neni 43, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 “ Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a,b,c dhe neni 40, i Ligjit nr. 1131/2015 “Per QKB”, i ndryshuar si dhe Ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit , në një vlerë **jo me te vogel se 40%** të vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet.

- a) **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontraten e mbikqyrjes, formularin e vleresimit per sherbimin e mbikqyrjes dhe faturat tatimore te shitjes se deklaruar ne organet tatimore, ku te shenohen datat, shumat si dhe objekti I mbikqyrjes se realizuar.
  - Per kontratat si Bashkim operatoresh, OE duhet te paraqese kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.
  - Per kontratat si nenkontraktor OE duhet te paraqese kontraten baze ndermjet kontraktorit dhe AK , kontraten e nenkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar te nenkontraktorit.

*Argumentime: Ky kriter bazohet në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.*

**2.3.2** Operatori / et duhet te jene te pajisur me Licenca Profesionale per “**Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi**” ,e vlefshme, sipas legjislacionit ne fuqi, te leshuar nga institucioni pergjegjes per dhenien e licensave sipas sipas legjislacionit ne fuqi:

- N.P–1 Punime gjermimi në tokë.
- N.P–4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- N.P–5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti
- N.P–7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi dhe vaditje.
- N.P – 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- N.S–1 Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S-6 Sinjalistika rrugore jodriçuese
- N.S-18 Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjines sipas përcaktimeve me siper. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e

tij ato kategori punimesh te kerkuara ne dokumentet e tenderit, pavaresisht se kategoria e kerkuar, nuk korrespondon me te njejtin numer kategorie me kategorine e punimeve ne licensen nje operatori te huaj te leshuar nga vendi I origjines.

Për operatorët e huaj, ne rast te shpalljes fitues , duhet te ekuivalentejo licencen sipas legjislacionit perkates para zhvillimit te fazes se dyte te tenderit.

**Argumentime:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave.*

**2.3.3** Punesim mesatar i te pakten 4 ( kater) personave, per periudhen te cilen duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise per minimumin 3 (tre) muajt e fundit, te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar si dhe listepagesat e punonjesve te konfirmuar nga autoritet perkatese sipas formatit qe kerkohet ne legjislacionin ne fuqi. Kerkesa do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetdeklarimit, dokumentat do te paraqiten nga OE i klasifikuar i pari perpara publikimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimit.

**Argumentime:** *Kerkesa eshte bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Percaktimi i numrit te punetoreve eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit si dhe me grafikun e punimeve.*

*Ky kriter nga numri i punonjesve te kerkuar si staf teknik i nevojshem per realizimin e sherbimit te mbikqyrjes per kete objekt bazuar ne licensat profesionale te kerkuara.*

*Per te vertetimin zoterimin e fuqise punetore jane kerkuar edhe vertetim leshuar nga Administrata Tatimore si dhe listepagesat e punonjesve mbeshetuar ne piken 6 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, qe parashikon se AK mund te percaktoje kriteret te tjera te vecanta, ne varesi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates.*

**2.3.4** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikëqyrjes , të cilët duhet të figurojnë në licencen e shoqerise , tw vwrretuar me kontratw pune tw vlefshme, librezw pune, diplomw pwrkatwse si dhe te figurojnw e listwpagesat e shoqwrsw si mwposhte:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier elektrik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/gjeodet/markshajder 1 (nje)

**Argumentime:** *Kerkesa per staf inxhinierik bazohet ne piken 4 te nenit 77, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 6/c e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit*

*public*". Stafit inxhinierik I kerkuar eshte ne perputhje me zbatimin e punimeve dhe zerave perkates ne preventive.

**2.3.5** Operatori / et ekonomik duhet te kene ne stafin e tyre personel te kualifikuar / certifikuar si meposhte:

- 1 (nje) punonjes "Ekspert zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin" ne perputhje me Ligjin nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin" shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, diplome / certificate nga Drejtoria e MZSH, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se oferatave ose me marredhenie kontraktore / kontrate (e noterizuar) me qellim ekzekutimin e kontrates object prokurimi. ( *Ne rast Bashkimi operatoresh ekonomike, te pakten njeri nga operatoret duhet te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi*).

**Argumentime:** Kjo kerkese bazohet ne nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar si dhe ne mbeshetje te nenit 49, pika 4, te Ligjit igjin nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin".

**2.3.6** Operatori / et ekonomik duhet te kene ne stafin e tyre personel te kualifikuar / certifikuar si meposhte:

- 1 (nje) punonjes te certifikuar "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune" ne perputhje me Ligjin nr.10237 date 18.2.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", VKM nr.312 date 5.5.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne Kantier" shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, diplome / certificate nga Drejtoria e MZSH, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimum per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se oferatave. ( *Ne rast Bashkimi operatoresh ekonomike, te pakten njeri nga operatoret duhet te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi*).

**Argumentime:** Kjo kerkese bazohet ne nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 39,pika 6, germa c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 10237 date 18.2.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", neni 7.

- 1 (nje) punonjes te certifikuar "Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave" e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise , shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, diplome / certificate nga Drejtoria e MZSH, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimum per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se oferatave. ( *Ne rast Bashkimi operatoresh ekonomike, te pakten njeri nga operatoret duhet te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi*).

**Argumentime:** Kjo kerkese bazohet ne nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 39, pika 6, germa c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 10237 date 18.2.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune”, neni 7.

Shenim: Per stafin e kerkuar ne 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6 , operatoret ekonomike e Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit , duhet te deklarojne emer, mbiemer, profili I punes, nr date e kontrates individuale te punes, numri dhe tituli I diplomes / kualifikimit si dhe institucioni qe ka leshuar kete dokument.

**2.3.7** OE duhet te disponoje ne pronesi/ qera / kontrate bashkepunimi instrumentat topografik si meposhte:

- 1 (nje) pajisje GPS
- 1 (nje) pajisje Total Station

Per keto pajisje duhet te paraqitet fatura tatimore shit-blerje ose kontrate qiraje/bashkepunimi ku I bashkangjitet fatura tatimore.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga OE te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST, dhe dokumentacioni I kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi I kualifikuar I pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

**Argumentime:** Bazuar në nenin 77 te Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publike” I ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

**2.3.8** OE duhet te disponoje dhe te paraqese certifikatat si meposhte:

- a) Certifikate e menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republiken e Shqiperise. Ne rast Bashkim Operatoresh cdo anetar I grupit duhet te paraqese certifikaten ISO 9001:2015: ose ekuivalente.
- b) Certifikaten e menaxhimit te mjedisit ISO 14001-2015 ( e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republiken e Shqiperise. Ne rast Bashkim Operatoresh cdo anetar I grupit duhet te paraqese certifikaten ISO 14001:2015 ose ekuivalente
- c) Certifikaten e menaxhimit te sigurise dhe shendetit ISO 45001-2018 ose certifikaten per standartin e perditesuar ISO 45001-2023 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republiken e Shqiperise. Ne rast Bashkim Operatoresh cdo anetar I grupit duhet te paraqese certifikaten e menaxhimit te sigurise dhe shendetit ISO 45001-2018 ose ose certifikaten per standartin e perditesuar ISO 45001-2023 ose ekuivalente.

Pranohet dhe paraqitja e standarteve shqiptare SSH mbi komformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga organizma te vleresimit te komformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise. Autoritetit Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga OE si me siper, ose ti kerkoje OE sqarime dhe dokumente mbeshetese ne perputhje me nenin 26, pika 7 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

***Argumentime:** Kerkesat e cilesise jane kerkuar ne mbeshetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 79, pika 1, ku percaktohet se “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të komformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 44, pika 1 dhe pika 3.*

Shenim: Kandidati ofertues ne perllogaritjen e ofertes duhet ti referohet njoftimit te bere ne nr. 5585, date 25.07.2017 te Agjesise se Prokurimit Publik “Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM -ne nr.354, date 11.05.2016 “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimi territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Shenim: Ne zbatim te pikes 1, te nenit 26, te VKM-se nr Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti / enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga Autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se dhe ne keto rregulla , si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, sjellim ne vemendje:

-OE pjesemarrres duhet te plotesojne formularin e ofertes sipas kerkesave te percaktuara ne shtojcen 1, pjese e ketyre dokumentave te tenderit.

- OE duhet te plotesojne listen e cmimeve te sherbimeve i cili eshte vene ne dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjese e ketyre dokumentave te tenderit.

-Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjesve do te paraqiten nga nga OE I kualifikuar I pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

-AK / enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fituesit do ti kerkoje ofertuesit te kualifikuar I pari, nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik e te dorezoje dokumentet provuese per vetedeklarimet e bera ne formularin permbledhes te vetedeklarimit si dhe dokumente te tjera te paraqitura ne Sistemin te Prokurimit Elektronik gjate fazes se ofertimit. **Mosparaqitja e dokumentacionit te sipercituar do te jete kusht skualifikimi.**

-AK do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera ne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit. **Konstatimi I mosperputhjeve midis formularit permbledhes te vetedeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht per skualifikim.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**